

FJALA E REKTORIT PROF. ASOC. DR. ARTAN DËRMAKU PËR 11 VJETORIN E UKZ

Të nderuar të pranishëm,

I nderuar kryetar i Komunës së Kamenicës Kadri Rahimaj

Të nderuar deputet, Ismail Kurteshi, Arjeta Rexhepi dhe Driton Hyseni

I nderuar kryetar i Bordit Industrial ne UKZ Arsim Vranovci

I nderuar kryetar i VV ne Kamenicë Bajram Mavriqi

Të nderuar anëtarë të Këshillit Drejtues të UKZ-së

I nderuar kryetar i Parlamentit Studentor z. Erblin Kastrati

Të nderuar prorektor, dekan, staf akademik dhe administrativ i UKZ-së

Të dashur studentë...

Të nderuar të pranishëm të tjerë,

Në këtë ditë të veçantë, me rastin e 11-vjetorit të themelimit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, dua që së pari të ju drejtohem me një përshëndetje të veçantë të gjithë kontribuuesve të këtij rrugëtimi të frytshëm, të cilët me pasionin, angazhimin dhe ndihmën e tyre kanë bërë të mundur suksesin e Universitetit Publik "Kadri Zeka".

Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, i themeluar 11 vite më parë, ka qenë dhe vazhdon të jetë një prej institucioneve më të rëndësishme në zhvillimin dhe përparimin e Gjilanit dhe rajonit përreth. Përmes kontributit të tij të palëkundur në arsim, kulturë, inovacion, ky universitet ka ndikuar pozitivisht në jetën e qytetarëve dhe ka sjellë një ndryshim të dukshëm në jetën akademike dhe sociale.

Në aspektin akademik, prania e Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan ka ofruar mundësi të reja arsimore për rininë e qytetit dhe rajonit, duke u mundësuar atyre që të ndjekin studimet e larta pranë shtëpisë. Kjo ka nxitur jo vetëm zhvillimin profesional të individëve por ka ndihmuar edhe në qëndrueshmërinë e talenteve lokale, të cilat tani kanë mundësinë të kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e komunitetit të tyre.

Në aspektin kulturor, universiteti ka qenë një qendër e rëndësishme që promovon dialogun, diversitetin dhe shkëmbimin kulturor. Aktivitetet dhe ngjarjet që organizohen nga universiteti janë bërë pjesë integrale e jetës kulturore në Gjilan.

Të ardhmen e universitetit e shënon përfaqimi i teknologjisë dhe digjitalizimit, veçanërisht në fushën e shkencave kompjuterike. Ky fokus jo vetëm që përputhet me kërkesat e tregut të punës global, por edhe vendos një themel të fortë për

zhvillimin e qëndrueshëm teknologjik të rajonit. Profilizimi në shkencat kompjuterike do të përgatisë studentët me aftësitë e nevojshme për të qenë konkurrues në një ekonomi gjithnjë e më të globalizuar dhe digjitalizuar, duke kontribuar në transformimin e Gjilanit në një qendër të inovacionit dhe teknologjisë në rajon.

Ky Universitet është një dritare e rëndësishme e dijes dhe qytetërimit, që mbart pas vetes shumë mund dhe shumë qëllime, dhe ka krijuar një rrjet të jashtëzakonshëm të lidhjeve ndërmjet akademisë, biznesit dhe komunitetit lokal. Në këto 11 vite, Universiteti ynë ka shërbyer si një qendër e përparimit akademik dhe zhvillimit shoqëror. Ndërthurur me synimet e larta të dijes dhe sfidat e botës së biznesit, kemi krijuar një ambient ku njohuritë dhe praktikat e reja janë promovuar dhe shpërndarë në mënyrë të përshtatshme për përfitimin e shoqërisë.

Pas 11 viteve të themelimit të tij, Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjilan vazhdon të jetë një dritare e shpresës dhe një motor i zhvillimit për të gjithë komunitetin. Përmes përkushtimit ndaj arsimit cilësor, inovacionit dhe bashkëpunimit.

Sot është dita kur mund të tregojmë rezultatet e viteve të themelimit.

Këtë vit është hera e 4 që UKZ është riakredituar suksesshëm si universitet, ndërsa në të gjitha proceset e akreditimit të programeve studimore bachelor dhe master deri më tani kemi dalë të suksesshëm.

Është krijuar sistemi i sigurimit të cilësisë, që d.m.th. janë krijuar dokumentet, organet dhe instrumentet për vlerësim, monitorim dhe raportim të cilësisë.

Në vitin e parë të themelimit mars 2013, UKZ ka filluar me 1039 studentë, ndërsa tani në Universitetin Publik “Kadri Zeka” janë 6878 studentë.

Staf akademik dhe administrativ vazhdimisht është rritur, nga 4 profesorë që ishin në vitin e parë të themelimit tani janë 55 profesorë me orar të plotë, kurse nga 7 zyrtarë të administratës sot UKZ ka mbi 33 zyrtarë administrativë.

UKZ apo fakultetet e tij janë themelues apo pjesë e 11 forumeve universitare, kombëtare e ndërkombëtare. UKZ ka nënshkruar mbi 50 marrëveshje bashkëpunimi me universitete të tjera, mbi 50 marrëveshje bashkëpunimi me bizneset, mbi 10 marrëveshje ICM dhe mbi 15 marrëveshje të tjera për projekte ndërkombëtare vetëm në vitin 2024, me një total prej 150 marrëveshjeve bashkëpunimi, prej të cilave shumica të aktivizuara dhe të suksesshme. UKZ është bashkorganizatore e shumë konferencave shkencore, ndërsa tashmë ka themeluar edhe Konferencën Vjetore të UKZ.

Stafi akademik i UKZ ka rritur ndjeshëm numrin e publikimeve shkencore dhe pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare, kanë punime në revista ndërkombëtare të indeksuara në web of Science apo në Scopus. UKZ do të fokusohet në këtë drejtim: të gjenerojë shkencë, pra informata, të dhëna, analiza, përfundime, rekomandime etj., të cilat do të jenë në dobi të shoqërisë, të ekonomisë dhe të sistemeve tona shtetërore.

UKZ, përveç interesit arsimor e shkencor, është edhe interes nacional, në dy aspekte, sepse është në trekëndëshin kufitar Kosovë-Serbi-Maqedoni e Veriut,.

Asgjë më shumë se universiteti nuk na bënë konkurrent në tregun global.

Edhe një herë faleminderit të gjithëve për kontributin tuaj të pashoq dhe mbështetjen e vazhdueshme! Nga studentët që kanë punuar palodhur për të arritur suksesin në karrierën e tyre, deri te stafi akademik që ka ofruar udhëzime dhe njohuri, dhe deri te partnerët tanë në biznes dhe komunitetin lokal, të cilët kanë qenë një forcë frymëzuese për inovacion dhe zhvillim të qëndrueshëm. Pa kontributin tuaj, universiteti ynë nuk do të ishte në gjendje të arrinte suksesin dhe ndikimin që ka sot.

Urime të gjithëve për këtë përvjetor!

Ju faleminderit

Gjilan, 06 Mars 2024